



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA MALËSI E MADHE  
KËSHILLI

Nr. 3698 / Prot.  
12

Koplik, më 12.12.2025

V E N D I M

NR. 54 , DATË 11 .12 .2025

**DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE FAMILJEVE TË DËMTUARA NGA  
FATKEQËSITË NATYRORE PËR VITET 2016-2025**

Këshilli Bashkiak Malësi e Madhe në mbledhjen e datës 11.12.2025, në mbështetje të ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 54, ligjit Nr.45/2019 “Për mbrojtjen civile”, VKM.329 datë 16.05.2012 “Për Kriteret dhe Procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të shkaktuara nga veprimtaria e njerëzore”, Vendim Nr.414 datë 08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për Mbrojtjen Civile”, si dhe shkresës Nr.5104/1 Prot. Datë 03.04.2025 “Miratim limiti për vitin 2025”, derguar nga Ministria e Financave

**V E N D O S I :**

1. Dhënie e ndihmës financiare prej 5,286,687 (pesë milion e dyqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e shtatë ) lekë për 18 (tetëmbëdhjetë) familje të Bashkisë Malësi e Madhe, të dëmtuara, për të përballuar dëmet e shkaktuara në banesat e tyre nga djegia gjatë viteve 2016-2024, sipas aneksit nr.1 bashkëngjitur këtij projekt vendimi.
2. Dhënie e ndihmës financiare prej 6,547,034 (gjashtë milion e pesëqind e dyzet e shtatë mijë e tridhjetë e katër ) lekë për 15 (pesëmbëdhjetë) familje të Bashkisë Malësi e Madhe, të dëmtuara, për të përballuar dëmet e shkaktuara në banesat e tyre nga djegia gjatë vitit 2025, sipas aneksit nr.2 bashkëngjitur këtij projekt vendimi.

3. Efektet: Krijon lehtësira për përballimin e situatës emergjente të banorëve të dëmtuar.

4. Burimi i financimit është: 7,563,962 (shtatë milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e tri mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e dy) lekë fond i vënë në dispozicion të Bashkisë Malësi e Madhe me shkresën Nr.5104/1 Prot. Datë 03.04.2025 “Miratim limiti për vitin 2025”, dërguar nga Ministria e Financave dhe 4 269 759 (katër milion e dyqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e nëntë) lekë fond i planifikuar në Buxhetin e Bashkisë Malësi e Madhe për vitin 2025, miratuar me VKB Nr.81 datë 31.12.2024 me burim financimi nga te ardhurat e trashëguara nga viti 2024.

5. Për zbatim të këtij vendimi ngarkohet: Drejtorja e Financës dhe Sektori i Emergjencave Civile pranë bashkisë Malësi e Madhe.

6-Ky vendim hyne në fuqi sipas nenit 55, pika 6 e ligjit Nr.139/2015 „Për vetëqeverisjen vendore“

**KRYETAR**

Ilir Halaj

**SEKRETAR**

Emirjan Hasmuaj

Miratuar me 11.12.2025

Vota Pro 19

Vota Kunder 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur me date 12.12.2025





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA MALËSI E MADHE  
SEKTORI I EMERGJENCAVE CIVILE

Nr. 3698/Prot.

Koplik, më 04.12.2025

PROJEKT - VENDIM

NR. \_\_\_\_\_, DATË \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2025

**DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE FAMILJEVE TË DËMTUARA NGA  
FATKEQËSITË NATYRORE PËR VITET 2016-2025**

Kryetari i Bashkisë Malësi e Madhe në mbështetje të ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 54, ligjit Nr.45/2019 “Për mbrojtjen civile”, VKM.329 datë 16.05.2012 “Për Kriteret dhe Procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të shkaktuara nga veprimtaria e njerëzore”, Vendim Nr.414 datë 08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për Mbrojtjen Civile” si dhe shkresës Nr.5104/1 Prot. Datë 03.04.2025 “Miratim limiti për vitin 2025”, dërguar nga Ministria e Financave

**VENDOSI:**



T’i propozojë Këshillit të Bashkisë Malësi e Madhe që të miratojë :

1. Dhënie e ndihmës financiare prej 5,286,687 (pesë milion e dyqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e gjshtëqind e tetëdhjetë e shtatë ) lekë për 18 (tetëmbëdhjetë) familje të Bashkisë Malësi e Madhe, të dëmtuara, për të përballuar dëmet e shkaktuara në banesat e tyre nga djegia gjatë viteve 2016-2024, sipas aneksit nr.1 bashkëngjitur këtij projekt vendimi.
2. Dhënie e ndihmës financiare prej 6,547,034 (gjashtë milion e pesëqind e dyzet e shtatë mijë e tridhjetë e katër ) lekë për 15 (pesëmbëdhjetë) familje të Bashkisë Malësi e Madhe, të dëmtuara,

për të përballuar dëmet e shkaktuara në banesat e tyre nga djegia gjatë vitit 2025, sipas aneksit nr.2 bashkëngjitur këtij projekt vendimi.

3. Efektet: Krijon lehtësira për përballimin e situatës emergjente të banorëve të dëmtuar.
4. Burimi i financimit është: 7,563,962 (shtatë milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e tri mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e dy) lekë fond i vënë në dispozicion të Bashkisë Malësi e Madhe me shkresën Nr.5104/1 Prot. Datë 03.04.2025 “Miratim limiti për vitin 2025”, derguar nga Ministria e Financave dhe 4 269 759 (katër milion e dyqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e nëntë) lekë fond i planifikuar në Buxhetin e Bashkisë Malësi e Madhe për vitin 2025, miratuar me VKB Nr.81 datë 31.12.2024 me burim financimi nga te ardhurat e trashëguara nga viti 2024.
5. Për zbatim të këtij vendimi ngarkohet: Drejtoria e Financës dhe Sektori i Emergjencave Civile pranë bashkisë Malësi e Madhe.

KRYETAR

TONIN MARINAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA MALESI E MADHE  
SEKTORI I EMERGJENCAVE CIVILE

Nr. 3698 Prot.

Koplik ,më: 04/17 /2025

RELACION  
PËR  
MIRATIMIN E DHËNIES SË NDIHMËS FINANCIARE FAMILJEVE TË DËMTUARA  
NGA FATKEQËSITË NATYRORE PËR VITET 2016-2025

Kryetari i Bashkisë Malësi e Madhe në mbështetje të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”,nenit 64 germa c, nenit 54 germa e/l propozon:

Të nderuar këshilltarë

Bazuar në Ligjin Nr.139 “Për Vetqeverisjen Vendore”, në Nenin 29 ku thuhet: “*Bashkitë janë përgjegjëse për garantimin e këtyre funksioneve*”:

*1. Mbrojtjen civile, në nivel vendor, dhe administrimin e strukturave përkatëse, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.*

VKM Nr.329, datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore” pika 1, “*Shteti ndihmon financiarisht të dëmtuarit, në rastet kur, si rezultat i fatkeqësisë natyrore ose fatkeqësive të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore, kanë pësuar dëme në njerëz dhe dëme materiale, në kushtet kur për përballimin e situatës:*

- a) është shpallur gjendja e emergjencave civile;*
- b) nuk është shpallur gjendja e emergjencave civile.*

Në Ligjin Nr.45/2019 “Për Mbrojtjen Civile” neni 65:

*1. Bashkitë, për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, si dhe kryerjen e detyrave në zbatim të këtij ligji, mbështeten në parashikimin minimal prej 4%( përqind) të totalit të buxhetit vjetor të tyre, të cilat sigurohen nga fondet e kushtëzuara të buxhetit të shtetit.*

*2. Bashkitë mund të planifikojnë fonde të tjera shtesë nga burimet financiare, si mëposhtë:*

- a) nga të ardhurat e veta vendore;*
- b) nga fondet që u vijnë drejtpërdrejt nga ndarja e taksave dhe tatimeve kombëtare, huamarrija vendore, donacionet;*
- c) si dhe burime të tjera të parashikuara në ligj.*

VKM Nr.414 dt.08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile” në pikën 3.

Fondi i kushtëzuar i buxhetit të shtetit për Mbrojtjen Civile të përdoret sipas prioritizimit sipas pikes 3.1, ku thekson se:

60% – 100% e fondit të dedikuar për mbrojtjen civile mund të përdoret për  
a) akordimin e ndihmës financiare për familjet, banesat e të cilëve janë dëmtuar nga një fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera, sipas kritereve specifike të përcaktuara në aktet nën ligjore që përcaktohen në ligjin nr.45/2019, “Për mbrojtjen civile”, neni 41;

Në Ligjin Nr.45/2019, “Për mbrojtjen civile”, neni 41 pika 2 thuhet : “Dëmet përballohen nga vetë bashkitë e prekura nga fatkeqësia, nëpërmjet fondit të dedikuar për mbrojtjen civile”si dhe pika 3 thuhet .”Në rast se bashkitë nuk kanë fonde të mjaftueshme për kompensimin, atëherë I planifikojnë ato për vitin pasardhës, deri në masën e kompensimit të subjekteve të dëmtuara”.

Gjatë viteve 2016-2025 janë djegur disa objekte banimi për të cilat është zbatuar procedura në zbatim të VKM Nr.329, datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtari njerëzore” dhe janë trajtuar sipas VKB përkatëse në masën 50,000 (pesëdhjetëmijë) – 100 000 (njëqindmijë) lekë si ndihmë e menjëherëshme.

Spektori i Emergjencave Civile menjëherë pas trajtimit nga ana e Këshillit të Bashkisë pas ndihmës së menjëherëshme i është drejtuar zyrtarisht Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile nëpërmjet Prefekturës së Qarkut Shkodër me shkresat përkatëse ku kërkonte dëmshpërblimin e vlerës së mbetur për të gjitha rastet. Theksojmë këtu se këto familje nuk janë trajtuar nga AKMC.

Në këtë Projekt Vendim trajtohen 18 (tetëmbëdhjetë ) familje te dëmtuara gjatë viteve 2016-2024, sipas vlerave të paraqitura në aneksin nr.1 te Projekt-Vendimit duke patur parasysh qe buxheti i bashkisë nuk mund t'i përballojë dëmet e plota për te gjitha familjet.

Gjithashtu, në këtë Projekt Vendim trajtohen 15 (pesëmbëdhjetë ) familje te dëmtuara gjatë vitit 2025, sipas vlerave të paraqitura në aneksin nr.2

Bashkangjitur relacionit janë anekset e detajuara me të gjitha të dhënat e nevojshme për argumentimin e fakteve që thamë më sipër.

Ju faleminderit për bashkëpunimin!

KRYETAR

TONIN MARINAJ



LISTA E FAMILJEVE QË PERFITONJË NGA FONDI PËR EMERGJENCAT CIVILE TË PRAPAMBETURA NDËR VITE  
DERI 2024

Nr.	Emer Atësia Mbiemri	Vendbanimi Nj-Ad	50% E Vlers Së Dëmit	Shuma E Marrë	Sasia E Mbetur	Shuma Që Jepet
1.	Shyqyr Hajdar Shabaj	Kastrat	825.499	550.000	275.499	275.499
2.	Xheladin Mujo Ademaj	Gruemire	3.126.285	1.550.000	1.576.285	500.000
3.	Preke Pashko Gjeloshaj	Shkrel	1.641.245	1.600.000	41.245	41.245
4.	Prele Gjeto Gjellaj	Kelmend	1.177.140	1.100.000	77.140	77.140
5.	Besnik Hamdi Kukaj	Qender Koplík	1.749.323	1.000.000	749.323	500.000
6.	Gjergj Kole Smajllaj	Kelmend	2.387.424	1.600.000	787.424	500.000
7.	Leze Ndue Vulaj	Kastrat	1.539.573	1.100.000	439.573	439.573
8.	Tringe Martin Lepeja	Gruemire	2.147.691	1.550.000	597.691	500.000
9.	Smajl Hasan Kurtulaj	Koplík	1.572.402	1.550.000	22.402	22.402
10.	Xhelal Adem Taflaj	Gruemire	1.069.254	1.000.000	69.254	69.254
11.	Gjoke Pal Gropcaj	Kastrat	840.958	600.000	240.958	240.958
12.	Prele Luigj Vitaj	Gruemire	1.318.658	1.100.000	218.658	218.658
13.	Fatmir Xhemal Haxhija	Qender	1.055.304	500.000	555.304	500.000
14.	Kole Gjelosh Kaiaj	Qender	150.950	100.000	50.950	50.950
15.	Engjel Gjon Makllaj	Shkrel	118.450	100.000	18.450	18.450
16.	Mirsad Selman Bajraktari	Koplík	432.558	100.000	332.558	332.558
17.	Llesh Prec Smajllaj	Kastrat	1.693.931	1.100.000	593.931	500.000
18.	Mare Gjelosh Nilaj	Kelmend	1.646.150	550.000	1.096.150	500.000
	<b>TOTAL</b>		<b>24.492.795</b>	<b>16.750.000</b>	<b>7.742.795</b>	<b>5.286.687</b>

Përgjegjës I Sektorit Të Emergjencave Civile

ARTAN BROJAJ



ANEKSI NR.2

LISTA E FAMILJEVE QË PERFITOJNE NGA FONDI PËR EMERGJENCAT CIVILE PËR VITIN 2025

Nr.	Emri Atësia Mbiemri	Vendbanimi Nj.Ad.	50% E Vleres Së Dëmit	Shuma E Marrë	Sasia E Mbetur	Sasia Që Jepet
1.	Leko Dode Brajovic	Qender	930.452	100.000	830.452	500.000
2.	Petre Dode Brajovic	Qender	389.325	100.000	289.325	289325
3.	Aleksander Gjovalin Makaj	Shkrel	1.084.806	100.000	984.806	500.000
4.	Kastriot Kanto Shabi	Kastrat	444.685	100.000	344.685	344.685
5.	Rasim Selman Semanaj	Qender	390.791	100.000	290.791	290.791
6.	Sulejman Begir Bercaj	Shkrel	921.207	0	921.207	500.000
7.	Fatbardha Sulejman Bercaj	Shkrel	921.207	0	921.207	500.000
8.	Nuri Begir Delaj	Kelmend	2.551.539	0	2.551.539	500.000
9.	Pretash Dode Nilaj	Kelmend	1.228.040	0	1.228.040	500.000
10.	Sejdin Islam Cokaj	Qender	390.791	0	390.791	390.791
11.	Gjon Ujk Broqi	Kastrat	125.861	0	125.861	125.861
12.	Gjovalin Gjergj Gjinaj	Gruemire	1.155.836	0	1.155.836	500.000
13.	Bashkim Binak Delaj	Qender	322.774	0	322.774	322.774
14.	Festime Haki Kukaj	Qender	282.807	0	282.807	282.807
15.	Zefan Kole Prekenicaj	Shkrel	1.778.731	0	1.778.731	500.000
	<b>TOTAL</b>		<b>12.918.852</b>	<b>500.000</b>	<b>12.418.852</b>	<b>6.547.034</b>



Përgjegjës I Sektorit Të Emergjencave Civile

ARTAN BROJAJ